



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 43 (827898)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 1 nëntor 2024

Këshilli i Ministrave miraton projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Forcës Rezerviste në Republikën e Shqipërisë”



» faqe 3

Sfidat e reja në detin Mesdhe dhe Ekonomia Blu, në fokus të Forumit të Rojës Bregdetare

Forumi i Funksioneve të Rojës Bregdetare Mesdhetare zhvilloi mbledhjen e tij të radhës në Tiranë, organizuar nga Forca Detare/Roja Bregdetare shqiptare. Qëllimi i këtij forumi është të rrisë bashkëpunimin midis agjencive të rojeve bregdetare të vendeve mesdhetare me përfaqësues nga 14 shtete anëtare, dy shtete vëzhguese, përfaqësues nga pesë agjenci dhe institucione të BE-së, si dhe organizata ndërkombëtare dhe institucione kombëtare.

Tema kryesore e forumit për këtë vit ishte “Sfidat e Reja në Detin Mesdhetar: Ekonomia Blu, Tranzicioni Ekologjik dhe Funksionet e Rojës Bregdetare”. Gjatë dy ditëve të forumit, u zhvilluan katër panele me fokus në praktikën më të mirë dhe bashkëpunimin ndërmjet vendeve.

Forumi MCGFF është një mundësi e shkëlqyer për të forcuar bashkëpunimin rajonal dhe për të adresuar sfidat e zakonshme në detin Mesdhe, duke promovuar një qasje të përbashkët për ruajtjen e burimeve dhe sigurisë detare.

Forumi i Funksioneve të Rojës Bregdetare Mesdhetare (MCGFF) është një platformë vullnetare, jo politike dhe e pavarur e përbërë nga 24 vende mesdhetare. Takimi i parë i MCGFF me iniciativën e Italisë u zhvillua në Gjenova, Itali në vitin 2009. Takimet e radhës të këtij forumi janë zhvilluar në Francë, Spanjë, Portugali, Itali, Turqi, Francë, Marok, Itali dhe Shqipëri.

I pranishëm në këtë takim ishte dhe Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, i cili përshëndeti përfaqësuesit e vendeve të Mesdheut, të mbledhur në Tiranë, në Forumin e Funksioneve të Rojës Bregdetare Mesdhetare, organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare e Bashkimit Evropian. Gjatë këtij Forumi, ministri i Mbrojtjes theksoi rëndësinë strategjike të detit Mesdhe për sigurinë rajonale dhe tregtinë ndërkombëtare, duke e cilësuar atë një korridor jetik për lëvizjen e mallrave midis Evropës, Afrikës dhe Lindjes së Mesme.

“Megjithatë, - theksoi ministri Vengu, - kjo rrugë kritike detare përballat gjithashtu me sfida të ndryshme sigurie, duke kërkuar masa të forta sigurie që nënvizojnë nevojën për përpjekje të përbashkëta”. Sipas ministrit të Mbrojtjes: “Rajoni i Mesdheut përballat me çështje të ngutshme si emigracioni i paligjshëm, kontrabanda dhe trafikimi i qenieve njerëzore, të cilat paraqesin kërcënime të rëndësishme për sigurinë dhe të drejtat e njeriut. Deti shërben si një rrugë kryesore transiti për mallrat e paligjshme, duke përfshirë drogën dhe armët, shpesh të ndihmuara nga rrjetet e krimit të organizuar që shfrytëzojnë kufijtë porozë të rajonit. Për më tepër, Mesdheu është një rrugë kritike për emigrantët që ikin nga konflikti dhe varfëria, duke çuar në rritjen e trafikimit të qenieve njerëzore. Këto sfida jo vetëm që rrezikojnë jetët njerëzore, por gjithashtu tendosin burimet kombëtare dhe destabilizojnë komunitetet. Trajtimi i këtyre çështjeve kërkon bashkëpunim të zgjeruar midis



vendeve mesdhetare, strategji të zbatimit të ligjit dhe qasje gjithëpërfshirëse që i japin prioritet shqetësimeve të sigurisë dhe shqetësimeve humanitare, duke krijuar një mjedis detar të sigurt dhe të drejtë për të gjithë”, - theksoi ministri i Mbrojtjes.

Z. Vengu vlerësoi rolin e Rojës Bregdetare si një rol jetik në ruajtjen e sigurisë dhe zbatimit të ligjit në mjedisin detar. Gjithashtu

ai vlerësoi partneritetet me agjencitë detare të BE-së si FRONTEX dhe EMSA për rritjen e efektivitetit të operacioneve të Rojës Bregdetare. Ndërsa shprehu angazhimin e palëkundur të Shqipërisë për bashkëpunim mes vendeve të Mesdheut: “Shteti shqiptar është i palëkundur në angazhimin e tij për të ofruar burimet dhe mbështetjen e nevojshme për operacionet efektive të Rojës Bregdetare, duke njohur rolin

kritik që Roja Bregdetare luan në ruajtjen e sigurisë detare dhe zbatimit të ligjit në det. Nëpërmjet investimeve të qëndrueshme dhe planifikimit strategjik, Shqipëria është e vendosur të fuqizojë Rojën Bregdetare për të përbushur misionin e saj në mënyrë efektive, duke përfutur përfundimisht komunitetet tona bregdetare dhe publiku i gjerë”, - theksoi ministri Vengu.



Këshilli i Ministrave miratoi në mbledhjen e tij të fundit, projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Forcës Rezerviste në Republikën e Shqipërisë”.

Ky projektligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e shërbimit rezervist në Republikën e Shqipërisë, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shtetasve, të organeve shtetërore e subjekteve private për mobilizimin. Projektligji, që funksionon si pjesë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, do të shërbejë për të siguruar individë të trajnuar, me qëllim kompletimin e strukturës së FA-së, ruajtjen e nivelit të gatishmërisë dhe operacionalitetit të kërkuar si dhe rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes, të nevojshme në kontekstin aktual të sigurisë në rajon e më gjerë si dhe për plotësimin e detyrimeve kombëtare në kuadër të NATO-s, operacioneve në përgjigje të krizave, operacionet e mbështetjes së paqes, sigurisë rajonale e globale si dhe operacionet e emergjencave civile.

Projektligji i ri përmban 34 nene që rregullojnë aspektet e organizimit të shërbimit në rezervë, përfshirë kriteret për pranimin, kohëzgjatjen e shërbimit dhe detyrimet e autoriteteve përkatëse. Shërbimi në rezervë do të përfshijë një forcë rezerviste që do të përbëhet nga 25% e forcave aktive, ose rreth 2100 personel, duke siguruar kështu një kapacitet të rëndësishëm për reagim të shpejtë në raste emergjente.

Sipas përcaktimeve të projektligjit të ri,

Këshilli i Ministrave miraton projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Forcës Rezerviste në Republikën e Shqipërisë”



ushtarakët, të cilët, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë dalë në rezervë sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si edhe shtetasit civilë, të cilët plotësojnë kriteret e pranimit të shërbimit ushtarak në rezervë, rekrutohen nëpërmjet procedurës së konkurrimit dhe nënshkruajnë kontratën përkatëse për shërbimin ushtarak në rezervë me kohëzgjatje jo më pak se 2 vjet me të drejtë rinovimi, por pa kaluar kriteret e qëndrimit në shërbimin ushtarak në rezervë.

Me përfshirjen e tij në strukturat rezerviste të Forcave të Armatosura, ushtarakët në rezervë gëzojnë të gjitha të drejtat si ushtarakët aktivë, ndërsa i jepet grada ushtarake që ka pasur në momentin e ndërprerjes së shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura. Shtetasit shqiptarë që nuk kanë shërbyer më parë në shërbimin ushtarak aktiv në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe që plotësojnë kriteret e pranimit në shërbimin ushtarak në rezervë titullohen dhe u jepet grada e parë ushtarake.

Projektet për Mbrojtjen Civile, ministri Vengu: Synimi i kësaj thirrjeje është produktiviteti, tavani buxhetor nuk ka qenë kurrë kaq i lartë

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu dhe drejtori i Përgjithshëm i AKMC-së z. Haki Çako, të shoqëruar nga ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja, prefekti i Lezhës z. Gjergj Premdi, në turin informues mbi çeljen e aplikimeve për paraqitjen e projekteve nga njësitë vendore në kuadër të Mbrojtjes Civile, u ndalën në qarkun e Shkodrës dhe në qarkun e Lezhës. Në takimin e organizuar me kryebashkiakët e bashkive të qarkut: Shkodër, Fushë Arrëz, Malësi e Madhe e Vau Dejës, ku ishin të pranishëm edhe prefekti, znj. Majlinda Angoni, u diskutuan problematikat që shqetësojnë pushtetin vendor në rast të përmbajtjeve apo zjarreve.

Gjatë fjalës së tij në këtë takim, ministri Vengu u shpreh se: “synimi i kësaj thirrjeje është që të ketë produkt”. Sipas ministrit të Mbrojtjes: “...tavani buxhetor nuk ka qenë kurrë kaq i lartë”. “Duhet që fronti i parë i reagimit të jetë njësia e pushtetit vendor, por kjo nuk e heq përgjegjësinë nga FA-në, që të jetë në vendngjarje, sa herë kërkohet ndërhyja”, - u shpreh ministri Vengu.

Sipas z. Vengu, emergjenca civile e suksesshme bazohet te njohuria sa më kapilare e terrenit. Ai bëri thirrje që edhe të rinjtë e zonave të mbështesin njësitë e Mbrojtjes Civile, në raste fatkeqësish natyrore.

Qarku i Shkodrës konsiderohet me nivel shumë të lartë të riskut nga përmbajtjet, që lidhet drejtpërdrejt me basenin e lumenjve Drin, Bunë (si dhe basenin e lumit Kir), me qendër në Shkodër. Edhe sa i përket zjarreve, ky qark vlerësohet me nivel të lartë të riskut, veçanërisht në ato zona, ku tokat bujqësore janë ngjitur me pyjet dhe ku tokat kullota janë të ndërlidhura me tokat pyjore.



Tre fushat në të cilat Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile u kërkon bashkive në të gjithë vendin të paraqesin projektet e tyre janë: investimet në infrastrukturë, ku do të pranohen projektet me një shumë totale financiare jo më të lartë se 100.000.000 lekë. Thirrja në këtë fushë përfshin edhe urat “Bailey”. Po ashtu është blerja e automjeteve për përdorim të veçantë, makineri teknologjike dhe mjete rrugore të veçanta, të përcaktuara si të tilla sipas parashikimeve të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë e që do të përdoren për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e fatkeqësive natyrore si dhe rehabilitimi i digave, ku kostoja totale e projektit nuk duhet të kalojë shumën prej 50.000.000 lekësh.



Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin “Për shërbimin e kërkim - shpëtimit në Republikën e Shqipërisë”

Kuvendi i Shqipërisë miratoi me 72 vota pro dhe 2 abstenim projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për shërbimin e kërkim - shpëtimit në Republikën e Shqipërisë”.

Ky projektligj ka si qëllim funksionimin e një shërbimi efikas dhe bashkëkohor të kërkim - shpëtimit, duke rregulluar fushën e përgjegjësisë së këtij shërbimi, si dhe duke iu përgjigjur nevojave aktuale për rristurimin e këtij shërbimi në respektim të përcaktimeve të detyrimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

Teksa mbrojti projektligjin në seancë plenare, ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu tha se ky ligj është një hap thelbësor, qoftë nga pikëpamja e linjimit me standardet ndërkombëtare, qoftë nga pikëpamja e rritjes së kapaciteteve të shërbimit të kërkim - shpëtimit në vendin tonë. Sipas ministrit Vengu, “gjatë tre viteve të fundit ka rritje të trafikut ajror dhe atij detar në vendin tonë dhe kjo vjen bashkë me detyrimin për të pasur një shërbim kërkim - shpëtimi më të mirë dhe një mbulim sa më të përafër me standardet, qoftë nga pikëpamja e incidenteve detare, qoftë nga pikëpamja e incidenteve ajrore”.

“Ndaj, - theksoi ministri i Mbrojtjes, - arsyeja kryesore e ndërhyrjes së qeverisë në këtë projektligj është mundësia që shërbimi i kërkim - shpëtimit, që ka lidhje me Forcën Ajrore, Forcën Tokësore, Forcën Detare, të jetë në lartësinë e kësaj sfide të re në vendin tonë”. Ndërsa arsyeja e dytë e ndërhyrjes, sipas Ministrit Vengu, ka të bëjë me linjimin me konventat ndërkombëtare dhe veçanërisht me Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar: “Në bazë të këtyre konventave, Shqipëria ka obligime ndërkombëtare për të ofruar një shërbim të besueshëm dhe efikas, të bashkërenduar me shërbime partnere, veçanërisht në rastin e aksidenteve ajrore dhe detare brenda rajonit të përgjegjësisë së kërkim - shpëtimit të Republikës së Shqipërisë”, - u shpreh ministri Vengu.

Në këtë ligj të ri parashikohet krijimi i funksioneve të mbikëqyrjes së kërkim - shpëtimit, që do të thotë se agjencia ekzistuese, që është Autoriteti e Aviacionit Civil, do të mbartë



sipas konventave ndërkombëtare dhe detyrën e monitorimit të shërbimit të kërkim - shpëtimit dhe do të auditojë rregullisht performancën, investimet, sistemet teknologjike gjithashtu edhe kapacitetet njerëzore në funksion të këtij shërbimi 24 orësh në vendin tonë.

Sipas këtij ligji të sapo miratuar parashikohet ngritja dhe funksionimi i Komitetit Kombëtar të Kërkim - Shpëtimit, pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Ky komitet do të kryesohet nga koordinatori Kombëtar i Kërkimit - Shpëtimit, i cili është Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura

dhe do të ketë anëtarë përfaqësues nga të gjitha ministratë përgjegjëse për fushën e kërkim - shpëtimit, si dhe nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Ky do të jetë autoriteti që do të bëjë edhe bashkërendimin e forcave në rast aksidentesh detare apo ajrore.



Në Departamentin e Gjuhëve të Huaja në AFA, u zhvillua një takim me Atasheun turk, kolonel Tolga KIP, në kuadër të rinovimit të kabinetit të turqishtes me materiale dhe mjete didaktike, dhuratë nga pala turke. Kabineti i turqishtes iu nënshtrua një rinovimi të plotë, duke u pajisur me tavolina, karrige, smartboard, laptop, printer, etj. Gjatë takimit u diskutua për shtrirjen e bashkëpunimit me palën turke në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies së gjuhëve të huaja.



Në ambientet e Qendrës së Arsimitit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit të 82-të Fillestar të Nënoficerit. Kohëzgjatja e këtij kursit ishte 5-javë stërvitore me modulet teorike dhe praktike. Kursantët morën njohuri mbi menaxhimin, drejtimin dhe organizimin e mësimin dhe stërvitjes në rolin e komandantit të grupit ose detyrave të njehsuara me të.



Gjeneralmajor Arben Kingji priti në takim komandantin e Komandës së Zhvendosjes së Shpejtë të Trupave të NATO-s, në Itali, gjenerallejtënant D'Addario

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji priti në një takim zyrtar komandantin e Komandës së Zhvendosjes së Shpejtë të Trupave të NATO-s, në Itali, (NATO Rapid Deployable Corps - Italy), gjenerallejtënant Lorenzo D'Addario.

Gjeneralmajor Kingji e njohu komandantin e NRDC, gjenerallejtënant D'Addario me zhvillimet më të fundit të Forcave të Armatosura, lidhur me procesin e modernizimit, përmirësimit të paketës ligjore, rritjes së kapaciteteve operacionale në përmbushje të detyrimeve kombëtare dhe ndaj NATO-s.

Gjatë takimit, biseda u fokusua kryesisht në rritjen e bashkëpunimit në fusha si stërvitje, trajnim dhe shkëmbimin e përvojave, në sfidat e përbashkëta të mjedisit aktual të sigurisë nisur dhe nga roli i ri i NRDC-ITA si “Forca Aleate e Reagimit (ARF)”, në mbështetje të Aleancës në tre detyrat e saj kryesore: parandalimin dhe mbrojtjen, menaxhimin e krizave dhe sigurinë bashkëpunuese.

Forca Aleate e Reagimit është një koncept i ri i dalë nga vendimet e Samitit të NATO-s, në Vilnius 2023, që i lejon SACEUR (Komandës Supreme Aleate) të ketë një forcë të gatshme për t'u angazhuar e përbërë nga të gjitha domenet, për të arritur një rezultat të shpejtë dhe një përgjigje efektive ndaj çdo lloji krize dhe operacioni.



Gjeneralmajor Xhebexhia pret drejtuesin e SFAB, major Hyland

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, priti në takim drejtuesin e ekipit të SFAB, major Hyland, në kuadër të përfundimit të misionit gjashtëmuajor të SFAB në Forcën Tokësore.

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia pasi i falënderoi për punën e bërë këto 6 muaj dhe rëndësinë e madhe që ka bashkëpunimi me SHBA si partner strategjik, u shpreh ndër të tjera se: “... është i domosdoshëm vazhdimi i mëtejshëm i trajnimit, kryesisht në disa fusha të veçanta që kanë lidhje me modernizimin dhe pajisjet e reja që Grup - batalioni i Këmbëorisë së Lehtë (GBLK) ka marrë vitet e fundit si dhe pritjet të marrë në të ardhmen...”.

Nga ana e tij, drejtuesi i ekipit të SFAB, major Hyland falënderoi gjeneralmajor Xhebexhia-n për mbështetjen e dhënë në këto gjashtë muaj, si dhe nënvizoi progresin e bërë nga Grup - batalioni i Këmbëorisë së Lehtë, në drejtim të trajnimit, stërvitjes dhe angazhimeve ndërkombëtare.

Misioni i SFAB pritet të vijojë dhe për 6 muajt e ardhshëm, duke u fokusuar në fusha specifike të trajnimit për GBLK, si dhe në strukturat e tjera të Forcës Tokësore.

Toga e Regjimentit të Këmbëorisë së Jugut të kontingjentit të IV “FLF BGR”, në Bullgari, përmbylli me sukses muajin e katërt të misionit në stërvitjen “FLASH”

Toga e Regjimentit të Këmbëorisë së Jugut e Kontingjentit të IV “FLF BGR”, (Forward Land Force Bulgaria), dislokuar në Novo Selo, Bullgari, në muajin e katërt të kryerjes së misionit, ka përfunduar me sukses angazhimet në kuadër të stërvitjes “FLASH”, duke treguar aftësi të shkëlqyera në skenarë luftimi.

Në bashkëpunim me forcat aleate të NATO-s, efektivet tanë shfaqën profesionalizëm dhe përgatitje të lartë, duke dëshmuar angazhimin e Shqipërisë në forcimin e sigurisë dhe stabilitetit në rajon.

Rezultati i kësaj stërvitjeje është reflektim i disiplinës dhe stërvitjes së vazhdueshme që efektivet kanë kryer në RKJ dhe në veçanti në trajnimin që këto trupa kryen gjatë stërvitjes paradisllokuese.



Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia pret në takim ekipin e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia priti në një takim ekipin e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit të kryesuar nga nënkolonel Jarret Feldman.

Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, pasi i uroi mirëseardhjen nënkolonel Jarret Feldman, e falënderoi për kontributin e dhënë nga Garda Kombëtare e Nju Xhersit, në mënyrë të veçantë për ndihmën e dhënë në trajnimin e personelit të Grup Batalionit të Këmbëorisë së Lehtë, për mirëmbajtjen e mjeteve HMMWV.

Takimi u fokusua në thellimin e bashkëpunimit, për zhvillimin dhe rritjen e aftësive të strukturave të Forcës Tokësore, në drejtim të mbështetjes logjistike.



Në auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua Konferenca Ndërkombëtare “Strategjitë dhe Doktrinat e Forcave të Armatosura në Mjedisin e Ri të Sigurisë”.

Në konferencë mori pjesë zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Dorian Tola, rektori i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, përfaqësues nga NATO, institucione të sigurisë dhe arsimit ushtarak, të cilët diskutuan mbi adaptimin e strategjive ndaj sfidave të reja, përvojat në doktrina dhe standardizimin me NATO-n.

Në konferencë u diskutua mbi tema: Teknologjitë moderne dhe luftën hibride.

Modelimi i përvojave në zhvillimin e doktrinaeve. Reflektimi mbi ambientin e ri të sigurisë. Krijimi i një kornize doktrinale kombëtare. Standardizimi i metodologjisë me NATO-n.

AFA zhvilloi Konferencën Ndërkombëtare “Strategjitë dhe Doktrinat e Forcave të Armatosura në Mjedisin e Ri të Sigurisë”



Specialistët e Kompanisë EOD, asgjësojnë municionet e rrezikshme në hotspotin Jub - Sukth, bashkia Durrës

Gjatë realizimit të operacionit për kontrollin dhe pastrimin nga municionet e paplasura në hotspotin Jub-Sukth, bashkia Durrës, ekspertët xhenerë kanë konstatuar municione të tipit trupa djegore të rrezikshme.

Personeli i kompanisë EOD, i trajnuar dhe certifikuar për pastrimin e zonave të ndotura nga municione të paplasura, bëri vlerësimin e detajuar të trupave të djegoreve dhe i klasifikoi ato si të rrezikshme e të palëvizshme.

Duke zbatuar masat e sigurisë ekipi EOD, realizoi asgjësimin në vend të municioneve, duke shmangur premisat për ngjarje të jashtëzakonshme.



Përfundoi operacioni EOD, në mbështetje të emergjencave civile në bashkinë Himarë

Ekipi i ekspertëve të Kompanisë EOD në Batalionin e Xhenios, i është përgjigjur kërkesës së autoriteteve përkatëse për vlerësimin e municioneve të paplasura të gjetura në fshatin Borsh.

Ekspertët, pasi siguruan perimetrin e zonës, bënë vlerësimin e kujdesshëm të municioneve dhe arritën në përfundimin se municionet e gjetura ishin predha artilerie E-TH 85mm.

Municionet e paplasura u konsideruan të lëvizshme dhe duke zbatuar të gjitha masat e sigurisë u bë transportimi dhe magazinimi i tyre në mjediset e Batalionit të Xhenios.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Mos më trego se çfarë thanë për mua! Por më thuaj ku e gjetën besimin tek ty që të flasin për mua!?



Çast reflektimi mbi fenomenin e gangrenizuar të shoqërisë njerëzore, thashethemet, sëmundja tumorale që është kthyer në pandemi. Ne vijmë në jetë prej njeriut dhe atashimin e parë e kemi me të parën ndjesi prekjeje, atë të nënës, largimi prej ngrohtësisë të trupit të saj, foshnjës i jep të dridhurat e frikës, panikut, e më tej mësohemi që me rritjen t’u besojmë ndjesitë tona, njerëzve të cilët mendojmë se i kemi krah dhe mbështetje.

Besimi është raport, është lidhje e ndërsjellë bashkëpunimi ndërmjet dy apo më shumë njerëzve, është relacion subjektiv, është një marrëdhënie ku njeriu jep dhe merr. Besimi i jep frymë arsyes njerëzore, njeriu me besim të shëndoshë frymon dhe jeton më lehtë dhe më mirë.

Roli i besimit është i pazëvendësueshëm në jetën e njeriut, sepse vetëm qenia njerëzore beson, i beson vetes, shokut, rezultatit të mirë të punës, ligjeve natyrore, lajmeve ditore, ngjarjeve të kaluara, rrethanave të sotme, fjalëve premtuese etj. Fitimi i parave është më i lehtë sesa fitimi i besimit të dikujt dhe asgjë nuk sjell më shumë kënaqësi sesa të dëgjosh fjalinë: “të besoj plotësisht”.

Dyshimi është si sëmundja e kancerit, e cila përhapet me shpejtësi në gjithë trupin e njeriut. Kur njeriun e “ha” dyshimi atëherë ai nuk sheh mirë si duhet, sepse gjërat i sheh me njërin sy e kjo do të thotë se nuk sheh me besim dhe optimizëm, por me dyshim dhe pesimizëm, nuk sheh me mirëkuptim dhe dashuri, por me fanatizëm dhe xhelozë, nuk sheh me ndjenja altruizmi por me ndjenja egoizmi dhe karrierizmi.

Shprehja e cila thotë: “Burri lidhet prej fjalësh e kau prej brirësh”, tregon njeriun e besimit të fortë, i cili e mban dhe e realizon fjalën e dhënë. Atëherë kur jemi në një fjalë me tjetrin, tregojmë besimin e palëkundur në vetvete dhe shtojmë mirëkuptimin, bashkëpunimin, shoqërinë dhe dashurinë në saj të besimit dhe besnikërisë. Sa e mirë është jeta kur besojmë, shpresojmë dhe jetojmë nga dashuria e vërtetë!

Nga besimi i vërtetë rrjedh optimizmi, gëzimi dhe hareja, sytë dhe fytyrat tona janë plot jetë. Çdo gjë duket ndryshe, e mirë, e kuptueshme, e buzëqeshur, e shkëlqyer, e suksesshme dhe e gatshme për fitore të reja kur besojmë. Kur je plot besim, paqe, gëzim dhe hare dallohesh nga të tjerët për shkak të reflektimit të dritës që ke. Kjo e bën njeriun qenie të qartë që bie në sy më shumë se të tjerët, sikur stina pranverore që dallohet për bukurinë e saj. Njeriun e tillë e dallon edhe në mes të turmës si ylli që dallohet në mesin e errësirës të turbullt.

Në jetën e përditshme bashkudhëtojmë me shpifjet, intrigat, akuzat e pathemelta, të cilat krijojnë dyshime, opinione të rreme, që të ndjekin si hija jote. Thashethemet janë bimë të këqija që mbijnë pa u mbjellë, që rriten pa u kultivuar, që edhe po t’i shkulësh në një vend, mbijnë në një vend tjetër. Janë si thëngjilli, përlyejnë njeriun për të cilin flitet, përlyejnë atë që e dëgjon, por edhe atë që e flet.

E vërteta është se 80 për qind e bisedave tona të përditshme janë shumë personale, dhe aty ka më shumë thashetheme se në çdo diskutim tjetër. Një nga arsyet se pse njerëzimi është kaq i dhënë pas thashethemeve është se në vetvete “ai është argëtues në mënyrën më të pa rezistueshme.

Meqë nuk e dimë se çfarë të tjerët mendojnë për ne, na pëlqen të koleksionojmë informacion herë pas here. Kështu bëjmë “detektivin” amator, pasi duam të jemi në mendjet e të tjerëve të dimë me çdo kusht se çfarë ata mendojnë. “Duke bërë thashetheme zbulojmë dhe njohim të tjerët më mirë. Ose njerëzit të paktën mendojnë se kjo është mënyra më e mirë për të njohur tjetrin.

Sigurisht që ka mënyra më të mira për ta bërë këtë, por duket se kjo është e pashmangshme për natyrën njerëzore. Të bërit e thashethemeve është në natyrën tonë.

KUR NJERIUN E “HA” DYSHIMI ATËHERË AI NUK SHEH MIRË SI DUHET, SEPSE GJËRAT I SHEH ME NJËRIN SY E KJO DO TË THOTË SE NUK SHEH ME BESIM DHE OPTIMIZËM, POR ME DYSHIM DHE PESIMIZËM, NUK SHEH ME MIRËKUPTIM DHE DASHURI, POR ME FANATIZËM DHE XHELOZI, NUK SHEH ME NDJENJA ALTRUIZMI POR ME NDJENJA EGOIZMI DHE KARRIERIZMI.

“Ne jemi pa diskutim trashëgimtarët e një tufe njerëzish që fusin hundët”

Ndoshta nuk do të ishte e nevojshme të merreshim me thashetheme për të mbijetuar, ashtu sikurse dhe paraardhësit tanë, por na ndihmon se kujt duhet t’i besojmë dhe se kujt jo.

Nga ana tjetër, ne na pëlqen të bëjmë thashetheme për t’i lënë të tjerëve të kuptojmë se cilët jemi ne. Ju pëlqen të flisni për pa besnikërinë e fqinjës suaj në lidhje me bashkëshortin e saj. Duke shprehur mendimin tuaj ju keni dhënë edhe fakte se çfarë karakteri apo morali keni vetë. Kështu ju zbuloni se duke bërë thashetheme, personi përballë jush ka të njëjtin mendim me ju ose jo.

Por mbi të gjitha nëse merreni me thashetheme në vendin e punës mund t’ju krijojë edhe lehtësira. Informohesh për kolegun tënd, di të mirat dhe të këqijat e tij, mëson se si të mbrohesh nga shefi apo të dëgjosh historitë e shoqes tënde më të mirë. Në vendin e punës nuk do të thotë domosdoshmërisht të merresh me thashetheme, por është e rëndësishme të dish se kush janë miqtë dhe armiqtë e tu. Kështu mund të mbrohesh dhe të sulmosh në rastin e parë që të jepet, ndaj mos qëndro indiferent duke iu shmangur thashethemeve, sepse kështu vetëm të tjerët do të merren me ty ndërsa ti do jesh subjekt i përhershëm diskutimi.

Një studim i kryer në vitin 2015 zbuloi në një periudhë 12

mujore se rreth 74 për qind e punonjësve nëpër zyra merren me thashetheme. Çdo ditë ata e nisin ditën e tyre të punës me fjalët e para që kanë dëgjuar, duke dashur që të jenë shpërndarësit e lajmit.

Thashethemet mund të lëndojnë, sidomos kur është i natyrës malinje, e kur nuk ka asnjë qëllim vetëm për të parë tjetrin poshtë.

(Thashethemet kanë pamje kameleonike, kanë helm gjarpri, herë të pickojnë si akrepi, herë të thithin gjak si ujku, herë të djegin si thëngjilli i mbuluar. Ka edhe shpifje e thashetheme që të shtijnë gjallë në dhe.)

Sot në Shqipëri edhe ajri më duket i ndotur prej thashethemeve. Vetëm e vërteta nuk besohet, faktet nuk dëgjohen, dokumentet fshihen e nuk lexohen. Shpifja është ngritur në art.

I madhi at Gjergj Fishta këshillonte: “Do të masë nieri fjalët e veta, sidomos kur të jenë të vërteta”

I urti tha: “O Zot, më ruej nga miqtë, se nga armiqtë ruhem vetë”.

Njeriu beson si i verbëri që beson në Diellin, jo pse e ka parë dritën e tij, por sepse e ndjen ngrohtësinë e ëmbël diellore. Kjo është meritë e energjisë së diellit, i cili është burim drite dhe ngrohtësie që mban gjallë tërë jetën në Tokë!

Ndaj është lehtë e besueshme të kuptosh, nëse ai përballë është miku yt, nëse vendos raportin e shprehjes: “Mos më trego se çfarë thanë për mua! Por më thuaj ku e gjetën besimin tek ty që të flasin për mua!?”

Operacionet për sigurinë e informacionit, rëndësia e tyre në dokumentet doktrinarë në FA, reagimi i Aleancës dhe përpjekja Kombëtare



Major (R) Agron BUKAÇI

Siguria kibernetike është një fushë e rëndësishme për mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe globale, dhe përbën një shqetësim të madh për shtetet dhe organizatat ndërkombëtare si NATO dhe BE. Ajo është një fushë e specializuar që fokusohet në mbrojtjen e sistemeve dhe rrjeteve kompjuterike nga sulmet dhe kërcënimet kibernetike. Me zhvillimin e teknologjisë dhe rritjen e sofistikimit të kërcënimeve, siguria kibernetike ka marrë rëndësi kritike për sigurinë kombëtare dhe globale. Kërcënimet kibernetike përbëjnë rreziqe të konsiderueshme për shtetet, NATO-n, BE-në dhe vendet anëtare të tyre.

Për herë të parë çështja e garantimit të sigurisë kibernetike të Aleancës u shfaq në axhendën aktuale politike të NATO-s, gjatë samitit në Pragë, në nëntor 2002, kur liderët e vendeve anëtare të Aleancës së NATO-s shprehën gatishmërinë e tyre për të forcuar aftësinë për të luftuar sulmet e informacionit.

Që nga samiti i NATO-s, Pragë 2002, filloi krijimi i organeve speciale të NATO-s, për shembull, si Agjencia e Komunikimit dhe Informacionit të NATO-s (NCIA), e cila karakterizohet si linja e parë e mbrojtjes së Aleancës kundër terrorizmit kibernetik.

Pasi Estonia iu nënshtrua një serie sulmesh kibernetike në prill dhe maj 2007, u shfaq në NATO një konsensus lidhur me perceptimin e kërcënimeve që burojnë nga hapësira e internetit si strategjikisht të rëndësishme.

Politika zyrtare e mbrojtjes kibernetike e NATO-s u miratua në janar 2008, nga Ministri i Mbrojtjes të NATO-s dhe iu prezantua organizatës në prill 2008, në samitin e Bukureshtit. Sipas deklaratës përfundimtare të samitit, ky dokument synonte të siguronte një aftësi për të ndihmuar vendet aleate, sipas kërkesës, për të kundërshtuar një sulm kibernetik.

Më 8 qershor 2011, një politikë e re e mbrojtjes kibernetike u miratua në një takim të Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s. Përmbajtja e të dy dokumenteve ende nuk do të vihet në dispozicion të publikut të gjerë.

Megjithatë, hapat praktikë të ndërmarrë nga NATO në zbatimin e politikës së sigurisë kibernetike mund të njihen. Kështu, në vitin 2008, u krijua Autoriteti i Menaxhimit të Mbrojtjes Kibernetike (CDMA). Funkcionalisht, CDMA-ja u thirr për të nisur dhe koordinuar veprimet e reagimit në rast të një sulmi kibernetik të drejtuar kundër ndonjë prej vendeve anëtare të NATO-s, ose vetë qendrës kryesore të NATO-s.

Qendra Bashkëpunuese e Ekselencës së Mbrojtjes Kibernetike (CCDCoE) në Talin, e cila mori akreditimin e NATO-s dhe statusin e një organizate ushtarake ndërkombëtare në tetor 2008, nuk ka funksione operacionale dhe shërben si qendër kërkimore dhe trajnimi, ku zhvillohen bazat doktrinare dhe konceptuale të sigurisë kibernetike dhe zhvillohen seminare trajnimi.

Kjo strukturë pozicionohet si burimi kryesor i ekspertizës unike ndërdisiplinore në fushën e kërkimit, trajnimit dhe ushtrimeve të mbrojtjes kibernetike që mbulojnë fushat e fokusit të teknologjisë, strategjisë, operacioneve dhe ligjit, që bashkon aleatët e NATO-s dhe partnerët përtej Aleancës.

Eksperti britanik Rex Hughes i konsideron këto dy organe të specializuara si elementë të një sistemi të vetëm organizativ. CDMA, që supozohet se zotëron aftësi të avancuara monitorimi elektronik



në kohë reale për identifikimin e kërcënimeve dhe ndarjen e inteligjencës kibernetike kritike në kohë reale, në nivelin taktik dhe operacional. CCDCoE pozicionohet si një “platformë intelektuale” për të menduarit afatgjatë doktrinar dhe strategjik.

Aktualisht është e vështirë të gjykohej se sa efektive janë këto institucione. Që nga incidenti i Estonisë dhe deri vonë, asnjë sulm kibernetik në shkallë të gjerë nuk është ndërmarrë as ndaj strukturave të NATO-s dhe as ndonjë prej anëtarëve të Aleancës.

Prandaj, duke qenë se CDMA shërben vetëm për “përdorim të brendshëm”, është mjaft e vështirë të vlerësohet efektiviteti i kësaj. CCDCoE midis akreditimit të saj në tetor 2008 dhe pandemisë COVID-19 në 2020, organizoi 12 konferenca ndërkombëtare mbi luftën kibernetike dhe konfliktet kibernetike, si dhe një numër seminaresh trajnimi.

Duke përfaqësuar një lloj “koalicioni të vullnetarëve”, domethënë një grup relativisht të ngushtë vendesh të bashkuar mbi bazën e interesit të përbashkët, kjo organizatë ka ende potencialin për të kryer konsultime për çështjet e sigurisë kibernetike midis vendeve anëtare të NATO-s. Kështu, në një kohë të shkurtër, NATO ka krijuar një sistem mekanizmesh dhe institucionesh të specializuara

për qëllime operacionale dhe strategjike.

Mund të pritët që shkalla e rëndësisë së këtij sistemi do të shfaqet në momentin kur NATO i nënshtrohet (dhe nëse i nënshtrohet) sulmeve të “intensitetit të lartë” - një akt masiv terrorist përmes rrjeteve globale të informacionit dhe/ose agresionit kibernetik të sponsorizuar nga shteti. Problemi i Sigurimit të sigurisë së teknologjive të informacionit dhe sistemeve të NATO-s dhe anëtarëve të saj, përveç çështjeve të mbështetjes teknike dhe planifikimit strategjik, ka një dimension politik.

Shqipëria (2023): Hakerët iraniane ndërprejnë rrjetet kompjuterike të qeverisë shqiptare, duke prekur shërbimet thelbësore dhe duke nxitur diskutime të rëndësishme për sigurinë kombëtare dhe strategjitë e mbrojtjes kolektive të NATO-s.

Çështje kryesore, vlerësime dhe sugjerime, vendi që duhet të zënë këto operacione në dokumentet doktrinarë në FA

Përhapja, zbatimi dhe përdorimi aktiv i teknologjive të informacionit kanë sjellë shpejt situatën ku këto teknologji filluan të përdoren jo vetëm si një mjet shkëmbimi dhe përpunimi i informacionit, por edhe si një mënyrë për të shkaktuar dëme.

Ekzaminimi i qasjeve për mbrojtjen nga kërcënimet kibernetike



“ ÇËSHTJA E GARANTIMIT TË SIGURISË KIBERNETIKE TË ALEANCËS U SHFAQ NË AXHENDËN AKTUALE POLITIKE TË NATO-S, GJATË SAMITIT NË PRAGË, NË NËNTOR 2002, KUR LIDERËT E VENDEVE ANËTARE TË ALEANCËS SË NATO-S SHPREHËN GATISHMËRINË E TYRE PËR TË FORCUAR AFTËSINË PËR TË LUFTUAR SULMET E INFORMACIONIT.

dhe sigurimi i sigurisë së informacionit brenda kuadrit të NATO-s shihen në dritën e faktit si çështje që i përkasin “sigurisë së butë”, ndërsa detyra kryesore e Aleancës është të kundërpërgjigjet ndaj sfidave konvencionale në tokë, në ajër, shihen si çështje që i përkasin “sigurisë së fortë”.

Sulmet kibernetike, duke mos qenë sulme të armatosura klasifikohen si luftë hibride që kundërshtari ndërmerr me qëllim cenimin e sigurisë së informacionit të një shteti të caktuar apo disa shteteve anëtare të Aleancës.

Është e nevojshme për të gjetur përgjigje për një numër pyetjesh vendimtare për hapësirën shtetërore të vendit tonë. Duke përcaktuar se: Cila është përmbajtja dhe niveli i kërcënimeve kibernetike? Cilat janë burimet e tyre?

Duke pasur parasysh se baza legislative dhe institucionet ndërkombëtare për të rregulluar sferën e marrëdhënieve ndërmjet aktorëve të ndryshëm të niveleve të ndryshme në hapësirën globale të informacionit nuk ekziston, ndërkohë që aksionet politike në sferën tradicionale të sigurisë euroatlantike dhe marrëdhëniet e ndërlikuara ndërmjet NATO-s dhe Rusisë janë të larta, është e duhur të shqyrtohet dimension i politik i sigurisë kibernetike brenda shtetit dhe zbatueshmëria e parimit të sigurisë kolektive për këtë sferë nga perspektiva e marrëdhënieve NATO-Rusi e më gjerë. Për këtë arsye dhe të tjera, çështjet e sigurisë së informacionit duhet të zënë vendin që u takon në dokumentet e të gjitha niveleve në FA.

Sulmet kibernetike dhe sulmet për ndërprerjet në furnizimet me energji duhet të shihen si kërcënime që kërkojnë reagim kolektiv. Vërehet se nga përkufizimi, sulmet kibernetike nuk janë “sulme të armatosura”, domethënë, ato nuk i nënshtrohen nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit, megjithëkëtë, Aleanca duhet të thotë diçka, NATO duhet të bashkohet përballë sulmeve që kërcënojnë një shtet anëtar.

Problemi i Sigurimit të sigurisë së teknologjive të informacionit dhe sistemeve të FA-së dhe strukturave të tjera që konsiderohen si elementë të fuqisë së shtetit, përveç se konsiderohet dhe është pjesë e çështjeve të mbështetjes teknike dhe planifikimit strategjik, ka një dimension politik, nga këtu del edhe ideja se përfshirja në çështjet e sigurisë së informacionit kap të gjitha nivelet.

Operacionet e mbrojtjes kibernetike të konsiderohen si beteja virtuale dhe mbi këtë bazë duhet të zhvillohen kapacitetet njerëzore infrastrukturore në FA.

NATO ka krijuar një sistem mekanizmesh dhe institucionesh të specializuara për qëllime operacionale dhe strategjike. Mund të pritet që shkalla e rëndësisë së këtij sistemi do të shfaqet në momentin kur NATO i nënshtrohet (dhe nëse i nënshtrohet) sulmeve të “intensitetit të lartë” - një akt masiv terrorist përmes rrjeteve globale të informacionit dhe/ose agresionit kibernetik të sponsorizuar nga shteti. Problemi i Sigurimit të sigurisë së teknologjive të informacionit dhe sistemeve të NATO-s dhe anëtarëve të saj, përveç çështjeve të mbështetjes teknike dhe planifikimit strategjik, ka një

dimension politik. Shteti Shqiptar dhe në veçanti FA-të, i kanë kushtuar një vëmendje të posaçme sigurisë së informacionit, duke krijuar një sistem mekanizmesh dhe institucionesh të specializuara për qëllime operacionale dhe strategjike.

Vlen të theksohet se e ardhmja e sigurisë së informacionit kombëtar dhe global do të varet nga shkalla në të cilën shtetet tregojnë vullnetin për bashkëpunim konstruktiv për zgjidhjen e problemeve urgjente të sigurisë së informacionit.

Në fund të fundit, meqenëse interneti nuk njihet kufij shtetërorë, atëherë përpjekjet për të garantuar sigurinë e tij duhet të jenë ndërkombëtare, kështu operacionet e mbrojtjes së informacionit apo sulmet për të përfituar informacion janë operacione të përbashkëta.

Operacionet për sigurinë e informacionit nuk janë sulme të armatosura, këto sulme kërcënojnë sigurinë kombëtare sikurse edhe sulmet e armatosura. Operacionet për sigurinë e informacionit duhet të gjejnë pasqyrim në dokumentet doktrinarë në FA, duhet të përfshihen tek kapitulli operacioneve mbrojtëse jo luftarake.

Operacionet për sigurinë e informacionit të klasifikohen si operacione të përbashkëta për faktin se strukturat tona të mbrojtjes kibernetike do të përfshihen në strukturat të mbrojtjes kolektive në kuadër të Aleancës, siç është Qendra e Ekselencës për Mbrojtjen Kibernetike të NATO-s.

Vlerësimet e sulmeve kibernetike

Sulmet kibernetike si formë e luftës hibride: Këto sulme përbëjnë sfida për identifikimin e burimeve dhe kërkojnë koordinim të ngushtë për përgjigjen efektive.

Mungesa e ligjeve gjithëpërfshirëse: E bën të vështirë koordinimin dhe përgjigjen e unifikuar nga NATO.

Dimensionet politike: Kërkojnë përfshirje të gjerë të qeverisë dhe burime të përmirësuar.

Mësimet e nxjerra nga sulmet kibernetike

Estonia (2007): Krijimi i politikës së parë të sigurisë kibernetike të NATO-s.

Konflikti Rusi-Gjeorgji (2008): Integrimi i sulmeve kibernetike në luftën konvencionale.

Shqipëria (2023): Nxjerrja e nevojës për një strategji të unifikuar për trajtimin e kërcënimeve kibernetike dhe kriteret për aktivizimin e nenit 5.

Synimet e së ardhmes: Për të adresuar kërcënimet e zhvilluar kibernetike, vendi ynë është në bashkëpunim të vazhdueshëm me NATO-n dhe aleatët e tij, duke u fokusuar në: Integrimin e sigurisë kibernetike; Në operacionet jo luftarake dhe të përbashkëta të NATO-s.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar: Forcimin e bashkëpunimit global për të trajtuar kërcënimet kibernetike ndërkufitare.

Edukimi dhe trajnimi: Zhvillimi i aftësive të sigurisë kibernetike përmes edukimit dhe praktikave më të mira.

Institucionet e specializuara: Krijimi i institucioneve të dedikuara për mbrojtjen e sigurisë kibernetike.

Integrimi Strategjik: Garantimi që siguria kibernetike është pjesë e të gjitha dokumenteve strategjike dhe doktrinare kombëtare dhe të NATO-s.

Përpjekjet Kombëtare

Kohë më parë por edhe pasi hakerët iranienë kryen sulm kibernetik ndaj institucioneve shtetërore dhe private, Shqipëria ka zhvilluar një Strategji Kombëtare të Sigurisë Kibernetike për periudhën 2020-2025, e cila fokusohet në adresimin proaktiv të kërcënimeve kibernetike në rritje. Kjo strategji përfshin zhvillimin e aftësive dhe përmirësimin e strukturave të sigurisë kibernetike për të rritur kapacitetet e mbrojtjes kibernetike, si dhe krijimin e një kulture të ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike brenda strukturave të FARSH-së dhe me institucionet e tjera kombëtare dhe të NATO-s.

FARSH-të do të rrisin aftësitë e tyre për t'u mbrojtur kundër kërcënimeve kibernetike, si në mënyrë të pavarur, ashtu edhe në bashkëpunim me strukturat e tjera kombëtare dhe të NATO-s. Kjo do të përfshijë zhvillimin e doktrinës në këtë fushë, konsolidimin e strukturave të sigurisë kibernetike (si Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike dhe funksioneve specifike në strukturat e FARSH-it), përmirësimin teknik dhe modernizimin e sistemeve dhe pajisjeve, si dhe nxitjen e një kulture ndërgjegjësimi për sigurinë kibernetike brenda strukturave të FARSH-it dhe me institucionet e tjera kombëtare dhe të NATO-s.

Nëpërmjet masave të mësipërme do të synohet të kuptohet rëndësia dhe sfidat e sigurisë kibernetike, si dhe përpjekje që duhet bërë për të përmirësuar mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj kërcënimeve në këtë fushë.

**Specialist/Kërkues për integrimin e STANAG/AP në Publikimet Doktrinare dhe Manualet Operacionale dhe Mbështetëse (PDMOM)*



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

U masakruan nga pushtuesi në luftë

Në Fjalorin e Shqipes së Sotme lexojmë këtë shpjegim për fjalën masakër: “vrasje e therje e njerëzve të pambrojtur në masë e në mënyrë mizore, kërdi, mizori, vras”. Pra masakër e fashistëve... masakruan pleq e fëmijë... Në “Fjalorin Enciklopedik Shqiptar të vitit 1985, ka të pasqyruar këto masakra: Masakra e Borovës 1943 (masakruar 107 veta), masakra e 4 shkurtit 1944 (masakruar 84 veta) dhe masakra e Manastirit të vitit 1830. Ndërsa në botimin e vitit 2008, plus këtyre pa ndonjë ndryshim, gjenden dhe masakra e Raçakut 15.01.1999 (masakruar 45 veta), masakra e Tivarit të vitit 1945, masakrat serbe në Kosovë në vitet 1998-1999 dhe masakra serbe në Kosovë pas vitit 1912. Në Shqipëri, gjatë LANÇ-it kanë ndodhur masakra nga pushtuesit nazifashist. Disa nga vendet ku kanë ndodhur masakrat janë shpallur dhe vende martire... janë publikuar në gazetën “Kushtrim Brezash” në vite, por dhe në revistën “Pavdekësia”, ku në numrin 3, mars-prill-maj, viti 1997 lexojmë për vende të shpallura martire. Të tilla janë Borova, Peza, Voskopoja, Kuçi, Vranishti, Përmeti, Mallakastra, Uznova, Smokthina, Vlushi... etj. Të masakruarit e kanë dhënë jetën duke qenë në luftë. Nuk është kurrë e tepërt t’i nderosh, të flasësh dhe të shkruash për të masakruarit. Nga ana tjetër, nuk mund të heshtim, para gjakut të tyre. Ende dhe sot, me qëllime të caktuara, fillojnë e numërohen varret e të rënëve në luftën për çlirim. Nga llogaritjet nuk u dalin 28 mijë, por më pak, deri dhe disa mijë... dhe kjo na qenka një mëkat i madh i historisë që duhet korrigjuar etj., etj. Kjo ndodh tek ne si në asnjë shtet tjetër në Europë, që duam të zvogëlojmë dhe të hedhim baltë mbi kontributet që na nderojnë. Kreu i shtetit shqiptar Enver Hoxha, më 1946 në Paris tha për 28 mijë të rënë, por Mit’hat Frashëri nga Radio Londra përmendi shifrën mbi 30 mijë. Por edhe nëse s’janë aq të rënë, nga ata me armë në dorë në përpjekje me nazifashistët, po gjaku i atyre shqiptarëve që humbën jetën në rrethana të tjera, pa armë e në ndihmë të luftës, e për hir të luftës, nuk është gjak të rënësh në luftë.

Masakrat filluan me Borovën dhe vazhduan në Lumën e Vlorës

Marrim masakrën e parë që njihet në Shqipëri gjatë LANÇ-it, në Borovë. Kolonja ka 104 dëshmorë, po gjaku i 107 borovarëve, më 6 korrik 1943, dhe mbi 40 të tjerëve nga Kagjinasi deri në Leskovik një ditë më pas, nuk duhet llogaritur dhe shpallur dëshmorë?... ende gazetat shqiptare dhe “Kushtrim Brezash”, kur shkruajnë nuk e dinë që 107 të masakruarit në Borovë janë shpallur Dëshmorë të Atdheut në vitin 2022. Po kush e di sa të tjerë viktimë nga reprezaljet, rrahjet, vrasjet e bombardimet, vdekjet në internime, etj., këta nuk duhen llogaritur? Duhet të fshihen nga historia? Po në shkallë vendi sa shkon kjo shifër, si ata të 4 shkurtit e kush e di sa të tjerë... Ende nuk dimë ndonjë bilanc të saktë për masakrat e kryera gjatë LANÇ-it. Siç e shikojmë në gjuhën zyrtare janë vetëm dy të regjistruara. Po të tjera, si janë regjistruar dhe deri ku jemi me evidentimin e tyre deri në masakrën e fundit... në këto masakra një pjesë e tyre, kush ka paraqitur dokumentacion janë shpallur dhe dëshmorë të Atdheut.

Më 4 shkurt 1944, në Boder të Smokthinës një ekspeditë gjermano-balliste kryen atë që ka hyrë në histori si “Masakra e Boderit”, duke vrarë shtëpi më shtëpi: Sefer Nuredin Birçaj, Rakip Selman Resulaj, Rrapo Imo Hitaj, Islam Maze Aliaj, Arif Hamit Jaupaj, Mustafa Zigur Muçaj, Manxhar Resul Rudaj dhe Damo Rushit Jahaj. Pra atë ditë u vranë 8 veprimtarë që punonin në thellësi të vendit, por që u vranë se ndihmonin partizanët. Nga këta, në vitin 1981 një u shpall dëshmor, ndërsa të tjerët u quajtën të masakruar. Por me ligjin 109/2018, u përgatitën dokumentet dhe në vitin 2021 u shpallën dëshmorë të Atdheut. Po kështu dhe të katër të masakruarit në Ramicë, në kohë të ndryshme gjatë luftës, me përgatitjen e dokumentacionit, janë shpallur dëshmorë të Atdheut.

Në pritën e Ndarëzave në Vranisht të Vlorës, midis forcave partizane dhe territoriale të fshatit, u arritën humbje të mëdha për gjermanët, u thyë imazhi i ushtarit gjerman si i pathyeshëm. Rreshtimi i 11 arkivoleve të ushtarëve gjermanë të vrarë në oborrin e shkollës së fshatit, në atë mëngjes dhjetori të vitit 1943, ishte mjaft domethënës. Më 18 dhjetor 1943, nazistët gjermanë në rrugë vranë 11 veta, burra dhe gra që kishin dalë për punë. Në pasditen e 9 shkurtit 1944, gati në t’u errur, Vranishti u gjet plotësisht i rrethuar nga të gjitha

Masakra të nazi-fashizmit në Shqipëri gjatë LANÇ-it



anët...ishin bllokuar rrugëdaljet e fshatit dhe kishin filluar menjëherë arrestimet në masë... burra të të gjithë moshave ta alarmuar, sakatuar e tronditur pa kuptuar asgjë, të detyruar po i çonin drejt qendrës së fshatit. Në këtë kohë, kur 60 burra po detyroheshin të bllokoheshin në një dhomë izolimi, gratë e fshatit, të gjitha së bashku, si në një kor të tragjeditë, lëshonin klithma të përvajshme, por në to ndihej njëherësh edhe thirrja për qëndresë, guxim për të mos u besuar nazistëve... Në Qaftë të Qarrit, më 9 shkurt, u masakruan 7 pjesëtarë të familjes Shakohoxha, në vendin Gjistar 4 pjesëtar të familjes Limoj, në Vranisht, më datë 10 shkurt, u masakruan 9 veprimtarë, ndërsa në Bartaj, natën e 10 shkurtit 1944, u masakruan plot 30 burra të fshatit, shpëtuan nga masakra 10 burra. Më 11 shkurt, pleqtë, gratë bile dhe fëmijët e Bratit, Vranishtit, Tërbaçit e të fshatrave përreth ishin kthyer të gjithë në lajmëtarë të vdekjes. Nga 61 të masakruarit në Vranisht, gati gjysma e tyre janë shpallur dëshmorë të Atdheut, duke filluar nga viti 1970 dhe deri në vitin 2024. Ushtaraku, dr. Mikado Shakohoxhaj ka shkruar librin “Masakra e Vranishtit”, botuar në vitin 2002 dhe në Brataj është vendosur një memorial që përkujton këtë masakër të vitit 1944.

Masakra e Shënkollit dhe 4 shkurti...

